

V E N D I M
Nr.534, datë 24.9.2001

**PËR TRAJTIMIN ME SHPËRBLIM TË PUNONJËSVE QË SHKURTOHEN NGA KALIMI
NË KONCENSION I MINIERËS SË KROMIT BULQIZË, FABRIKËS SË PASURIMIT
BULQIZË, IMPIANTIT TË SELEKSIONIMIT KLOS DHE UZINËS SË FERROKROMIT
BURREL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës të privatizimit të shoqërisë anonime “Albkrom”” dhe të nenit 4 të ligjit nr.8791, datë 10.5.2001 “Për miratimin e “Marrëveshjes së koncensionit të formës “ROT” të Minierës së Kromit Bulqizë, Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit Klos, dhe të Uzinës së Ferrokromit Burrel ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë të së drejtës italiane “Darfo” s.p.a”, si dhe dhënies së disa stimuljeve dhe garancive për koncensionarin e kësaj Marrëveshjeje”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësve të njësisë së Minierës së Kromit Bulqizë, Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, Impiantit të Seleksionimit Klos dhe Uzinës së Ferrokromit Burrel, të cilët shkurohen si rezultat i zbatimit të marrëveshjes së koncensionit, të miratuar me ligjin nr.8791, datë 10.5.2001, t’u jepet një shpërblim i barabartë me pagesën bazë të vendit të punës të 2 (dy) viteve. Fondet e nevojshme prej 248 000 000 (dyqind e dyzetë e tetë milionë) lekësh sigurohen nga koncensionari.

2. Shpërblimi i punonjësve të bëhet me 8 (tetë) këste; secili këst është 3 (tre) muaj. Pagesa e shpërblimit fillon nga data 16.7.2001.

3. Përfitojnë shpërblim të barabartë me pagën bazë të dy viteve punonjësit, të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune, pandërprerje, në njësinë përkatëse që nga data 22.6.2000, punonjësit që nuk përfitojnë nga privatizimi i objekteve të veçanta të njërive respektive dhe punonjësit që nuk përfitojnë trajtim të veçantë, në mbështetje të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta